

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Analizat e biznesit
Business Analysis

P11

Zgjidhjet
11.10.2025

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Problemi 1

Një ndërmarrje botuese e gazetave, Delta Grupi Ndërkombëtar, po kalon nëpër rishikim të proceseve të saj të biznesit me qëllim përmirësimin e konkurrencës dhe performancës së saj financiare.

Kjo kompani tanimë ka vendosur të transferojë departamentin e brendshëm ligjor, i cili përdoret, siç kërkohet, rast pas rasti, ose për të mbrojtur kompaninë kur dikush sjell një padi kundër saj, ose për të kontrolluar nëse shkel ndonjë ligj kur publikon një artikull, duke marr shërbime ligjore nga një kompani e jashtme.

Kompania beson se ky proces është vendimi i saktë, pasi kërkesa për punën është e rrallë dhe e paparashikueshme për këtë departament. Aktualisht ajo duhet të ruajë aftësitë e nevojshme ligjore brenda kompanisë, së bashku me financimin e trajnimit të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për t'i mbajtur ato aftësi të stafit të azhurnuara. Kompania beson se kontrata e jashtme do të jetë më e lirë dhe do të lejojë që të përdoret ekspertiza e duhur ligjore kur kërkohet.

Kompania ka identifikuar tre procese të tjera që mendon se kanë nevojë për rishikim:

Botim i gazetës ditore financiare

Kjo është marka kyçe në grupin Delta. Kompania krenohet me sigurimin e artikujve të detajuar të lajmeve financiare nga e gjithë bota. Artikujt që publikohen janë mjaft të lexuar midis profesionistëve të financave dhe drejtuesve të ndërmarrjeve. Sidoqoftë, popullariteti i gazetës ka qenë në rënie, me ankesa nga lexuesit e saj se asaj i mungon analiza dhe komenti i mjaftueshëm editorial i nivelit të lartë, në vend që thjesht të raportojë faktet. Lexuesit kanë sugjeruar që shumica e këtij informacioni tani mund të gjendet në internet, kështu që gazeta duhet të sigurojë diçka më shumë.

Procesi i botimit të gazetës përdor shumë reporterë, të cilët punojnë nga vende të shumta në të gjithë botën. Kur shpërthen një histori, redaktori i gazetës porosit një artikull nga reporteri më i afërt gjeografikisht. Këta reporterë punojnë për të gjitha gazetat brenda Grupit Delta siç kërkohet dhe kështu nuk janë profesionistë të specializuar të financave. Gazetarët dërgojnë artikuj me email. Afatet për dorëzim janë të shpejta. Këto nënkuptojnë që anëtarët e redaksisë, përgjegjës për artikullin përfundimtar, shpesh nuk kanë kohë për të kontrolluar cilësinë e artikullit ose për të shtuar komente të nivelit të lartë.

Menaxhimi i abonentëve

Megjithëse Delta Grup ka një rrjet të gjerë shpërndarjeje, duke shitur gazetën ditore financiare dhe gazetat e tjera përmes supermarketeve dhe shitësve të gazetave, shumica e të ardhurave të kompanisë vijnë nga abonentë të rregullt, të cilëve u shpërndahen gazetat direkt. Abonentët menaxhohen nga një ekip i marrëdhënieve me klientët të cilët operojnë nga zyra qendrore. Secili anëtar i ekipit është përgjegjës për një numër abonentësh. Nëse anëtar i duhur i ekipit është i padisponueshëm kur një abonent bën thirrje me pyetje, abonentit i kërkohet të telefonojë përsëri më vonë. Si rezultat i kësaj politike, një numër abonentësh janë larguar kohët e fundit dhe të ardhurat e kompanisë po bien. Pyetjet e abonentëve janë mjaft të thjeshta, siç janë faturimi i pasaktë ose çështjet e dorëzimit të gazetave.

Pagat

Grupi Delta ka një departament të brendshëm të pagave, i cili ka vështirësi të merret me shumëllojshmërinë e kushteve të pagesës për punonjësit e tij të ndryshëm. Disa reporterë paguhen në bazë të artikullit, ndërsa të tjerët paguhen me pagë të rregullt mujore. Për më tepër, ka pagesa bonusi për stafin nëse shitjet javore tejkalojnë shifrat e caktuara të synuara. Ka gabime të rregullta në këto pagesa dhe stafi, përfshirë reporterët, gjithnjë e më shumë po kalojnë kohë duke u përpjekur të zgjidhin këto gabime me departamentin e pagave.

Grupi Delta ka identifikuar tre fusha të procesit për përmirësim: botimi i gazetës ditore financiare, menaxhimi i abonentëve dhe pagat.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni secilën nga tre fushat e procesit të identifikuara më sipër duke përdorur matricën proces-strategji të Harmonit. Rekomandoni dhe arsyetoni strategji përmirësimi, për secilin nga tre proceset, e cila adreson problemet me të cilat përballet secili. (15 pikë)

Grupi Delta tashmë ka vendosur që proceset e tij ligjore të përmirësohen përmes kontraktimit të jashtëm.

Kërkohet:

(a) Shpjegoni disavantazhet dhe rreziqet që lidhen me kontraktimin e departamentit ligjor dhe diskutoni se si mund të menaxhohen këto rreziqe. (10 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

(a) Grupi Delta mund të vlerësojë përparësinë e tre proceseve në matricën e strategjisë së procesit të Harmonit. Matrica ka dy boshte. Boshti vertikal ka të bëjë me kompleksitetin e procesit. Kompleksiteti i ulët i procesit i referohet procedurave të thjeshta ose rutinë me pak inpute, ndërsa proceset tepër komplekse mund të konsiderohet se kanë nevojë për një nivel të lartë aftësie, të jenë jo-rutinë dhe të përdorin një larmi të inputeve të ndryshme.

Boshti horizontal merr në konsideratë rëndësinë strategjike të këtyre proceseve. Proceset me rëndësi të ulët kanë të bëjnë me gjërat që duhet të bëhen, por që u shtojnë pak vlera produkteve ose shërbimeve. Sidoqoftë, proceset me vlerë të lartë janë shumë të rëndësishme për suksesin dhe shpesh konsiderohen të jenë proceset thelbësore. Nga këto dy boshte, Harmon kategorizon katër kuadrantë dhe bën sugjerime se si duhet të trajtohen proceset në secilin kuadrant, siç është përmbledhur në Figurën 1.

Rëndësia strategjike

Lartë

Ulët

<p>Lartë</p> <p>Kompleksiteti i procesit</p>	<p>Procese komplekse dhe dinamike, por jo pjesë e kompetencave thelbësore</p> <p>BURIMI NGA JASHTE</p>	<p>Procese komplekse, dinamike, që jenerojnë avantazh konkurrues</p> <p>PERMIRËSIMI I PROCESIT FOKUSIMI TE NJERËZIT DHE NDËRVEPRIMET E TYRE</p>
<p>Ulët</p>	<p>Procese të thjeshta-automatizim me sisteme jashtë raftit</p> <p>AUTOMATIZIM OSE BURIMI NGA JASHTE</p>	<p>Procese të thjeshta por të rëndësishme</p> <p>AUTOMATIZIM</p>

Figura 1 - Matrica e Procesit/strategjisë së Harmonit

Secili prej tre proceseve mund të vlerësohet nga ana tjetër duke përdorur matricën, si më poshtë:

Botimi gazetës ditore financiare

Kjo duket të ketë një rëndësi të lartë strategjike për grupin, si dhe të një kompleksiteti të lartë. Skenari thotë se kjo është një nga markat kryesore brenda Grupit Delta, me emër të mirë të brendit. Mund të konsiderohet si biznes kryesor dhe për këtë arsye me rëndësi të lartë strategjike për grupin. Matrica sugjeron që ky proces të mbetet i brendshëm.

Procesi i botimit të kësaj gazete nuk mund të përcaktohet si i thjeshtë; kërkon staf të ditur me aftësi të mira komunikimi për të tërhequr lexuesit. Burimet janë të shumta dhe të larmishme, dhe obligimet për autorët nuk ka gjasa të jenë të përsëritura.

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj gazete për grupin dhe rënien e fundit të lexuesve, është thelbësore që procesi të përmirësohet për ta përmirësuar situatën. Matrica sugjeron përmirësimin e procesit duke u përqëndruar te njerëzit. Ajo mund të jetë se Grupi Delta rekruton gazetarë të dedikuar të financave për të rritur përmbajtjen ose si alternativë trajnon stafin e vet të raportimit në aftësitë redaktuese. Sidoqoftë, duket se mund të përmirësohet mënyra në të cilën reporterët ndërveprojnë me gazetën. Nëse punimi do të prezantonte një verzion në internet, stafi i redaksisë mund të komentonte mbi artikujt e siguruar nga reporterët, edhe pas botimit të artikujve.

Menaxhimi i abonentëve

Ky është një proces relativisht i thjeshtë; ka të ngjarë të jetë i përsëritur dhe i drejtpërdrejtë për tu menaxhuar, me pak ndërhyrje në proces. Duke qenë se është një rrjedhë e rëndësishme e të ardhurave për Grupin Delta, ai duhet të sigurojë që procesi të jetë i efektshëm dhe t'i përshtatet nevojave të abonentëve. Kjo duhet të adresojë rënien e abonentëve, së bashku me veprimet e ndërmarra në lidhje me botimin.

Matrica sugjeron përmirësimin e procesit përmes automatizimit dhe kjo do të ishte ideale në këtë situatë. Një sistem i automatizuar i menaxhimit të marrëdhënieve me klientin do të siguronte që të gjitha detajet e abonentit të ishin ruajtur dhe të disponueshme për të gjithë anëtarët e ekipit të marrëdhënieve me klientin. Në këtë mënyrë, çdo anëtar i ekipit do të jetë në gjendje t'i përgjigjet një pyetjeje të klientit me njohuri të plota dhe të merret menjëherë me çdo çështje. Ka shumë sisteme të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët që ka të ngjarë të plotësojnë nevojat e kompanisë dhe duhet të sigurojnë që procesi të jetë i efektshëm.

Lista e pagave

Lista e pagave është një proces mjaft i drejtpërdrejtë, por departamenti i pagave duket se po e bën atë më kompleks se sa duhet. Ekzistojnë rregulla që nënkuptojnë se çdo aktivitet brenda këtij procesi duhet të jetë rutinë, edhe nëse ato nuk ndodhin në të njëjtën mënyrë për çdo anëtar të stafit.

Edhe pse është e rëndësishme që punonjësit të pagohen në shumën e duhur, në kohën e duhur, procesi i pagimit të stafit nuk është strategjikisht i rëndësishëm pasi nuk mund të

sigurojë avantazh konkurrues për kompaninë.

Prandaj matrica sugjeron që ky proces të kontraktohet ose automatizohet. Mund të ndodhë që të mos ekzistojë një sistem i përshtatshëm, i cili përfshin rregulla të ndryshme pagese. Nëse është kështu, atëherë Grupi Delta duhet të konsiderojë kontraktimin nga jashtë të listës së pagave, e cila do të menaxhojë procesin në mënyrë profesionale dhe gjithashtu duhet të përfitojë nga ekonomia e shkallës. Kjo mund të zvogëlojë koston për Delta grupin dhe duhet të heqë çdo demotivim të shkaktuar nga procesi aktualisht i gabuar.

(b) Grupi Delta tashmë ka vendosur të transferojë departamentin e tij ligjor, kështu që duhet të jetë i vetëdijshëm për disavantazhet dhe rreziqet e përfshira, në mënyrë që të përpiqet të menaxhojë ato rreziqe.

Shërbimet ligjore ka të ngjarë të jenë të kushtueshme, duke pasur parasysh nivelin e ekspertizës së kërkuar. Ofruesit e kontraktimit duhet të fitojnë një diferencë fitimi për shërbimet e tyre. Kështu, mundësia për kursime të përgjithshme të koston do të varet nga sa shpesh dhe për sa kohë, ky shërbim është i nevojshëm.

Është e mundshme që duhet të paguhet një tarifë vjetore, e cila mund të përfshijë ose jo të gjitha shërbimet.

Ekziston rreziku i rritjes së kostove në të ardhmen, nëse përdoret një kontraktor i vetëm, pasi mund të jetë e vështirë për Delta Grupin të kalojë te një ofrues tjetër në fund të periudhës së kontratës.

Ekzistojnë firma të shumta për tu zgjedhur dhe rreziku është që Delta Grupi të mos arrijë të zgjedhë ofruesin më të mirë për nevojat e tyre. Firmat ligjore ofrojnë një larmi shërbimesh dhe shpesh specializohen në fusha të veçanta. Nëse kompania nuk ka pasur nevojë për një shërbim specifik ligjor më parë, mund të ndodhë që ofruesi i tyre i zgjedhur nuk mund t'i plotësojë këto nevoja.

Shërbimet ligjore janë shumë konfidenciale, veçanërisht nëse grupi po shqyrton këshillat ligjore për artikujt që nuk janë botuar ende. Mund të shqetësohet që përmbajtja e artikujve të rrjedhë në një farë mënyre tek konkurrentët, veçanërisht nëse ata ndajnë të njëjtën kompani të jashtme.

Duke pasur parasysh ekspertizën e kërkuar, do të jetë e vështirë për grupin të kthejë këtë proces brenda kompanisë nëse kontraktimi i jashtëm nuk funksionon.

Kontraktimi i jashtëm gjithashtu mund të çojë në humbjen e kontrollit mbi cilësinë. Sidoqoftë, një firmë ligjore me qasje në shumë staf duhet të jetë e aftë të ofrojë një shërbim me cilësi të lartë, ndoshta me një cilësi më të lartë se një departament i vogël juridik brenda një kompanie.

Në mënyrë që të menaxhojë rrezikun e koston, Grupi Delta duhet të sigurojë që të ketë një marrëveshje plotësisht të rënë dakord për nivelin e shërbimit, e cila detajon gjithçka që përfshihet në tarifat e hollësishme për çdo shërbim shtesë.

Në mënyrë të ngjashme, marrëveshja e nënshkruar mund të përdoret për të siguruar që nuk ka rrezik për konfidencialitet.

Rreziku që kontraktuesi të mos jetë në gjendje të përmbushë nevojat e tyre mund të tejkalohet

me një vendim për të kontraktuar një shumëllojshmëri të firmave ligjore kundrejt kontraktimit të një firme të vetme.

Problemi 2

Rishikuesit e Dyqaneve Online (RDO) u themelua në vitin 2010 nga Amy Needham. Ajo ndjeu se shumë konsumatorë që blejnë nga dyqanet në internet ishin mashtruar nga reklamat dhe shumë shpesh, produktet e blera ishin të pasigurta, me defekte ose nuk arritën të përmbushnin pritjet e konsumatorëve. Amy besonte se industria online e shitjes me pakicë gjithnjë po vepronte joetikisht, duke u kujdesur vetëm për fitime në kurriz të nevojave dhe pritjeve të konsumatorëve.

Rrjedhimisht, ajo ngriti RDO për 'ofrimin e një rishikimi të paanshëm të dyqaneve online për të siguruar që konsumatorët kanë të gjitha informacionet në dispozicion'. Kompania ofron komente për dyqanet e tanishme online dhe siguron lidhje të drejtpërdrejta për konsumatorët të blejnë në dyqanet e paraqitura në faqen e saj. Rishikimet përfshijnë krahasimin e çmimeve, të siguruara nga RDO, si dhe vlerësimet e përgjithshme të ofruara nga përdoruesit e regjistruar të faqes. Kompania ka dy burime kryesore të të ardhurave. E para është të ardhurat nga reklamat nga dyqanet online të cilët vendosin reklama në faqen e RDO-së. Burimi i dytë i të ardhurave është komisioni nga shitjet nga dyqanet online për konsumatorët të cilët kanë klikuar në lidhjet e sponsorizuara të ofruara në faqen e internetit të RDO-së. Ky komision paguhet vetëm nga dyqanet që kanë hyrë në një marrëveshje të tillë komisioni me RDO.

RDO mbështetet në faqen e saj të internetit e cila është në dispozicion online 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Për këtë arsye ka serverë rezervë që funksionojnë njëkohësisht me serverët kryesorë në të cilët të dhënat përpunohen dhe ruhen. Serverat janë të lidhur direkt në mënyrë që çdo përditësim në serverët kryesorë ndodh automatikisht në serverët rezervë. Serverat janë vendosur të gjithë në të njëjtën qendër kompjuterike në zyrën qendrore të kompanisë. Qendra kompjuterike ka rritur sigurinë e saj duke zbatuar një sistem të njohjes së gjurmëve të gishtave për kontrollin e qasjes në vend. Megjithatë, meqenëse shumica e stafit në zyrat qendrore janë punonjës të IT-së dhe shpesh punonjës të përkohshëm punësohen për të mbuluar mungesat, sistemi i njohjes së gjurmëve të gishtërinjve nuk është gjithëpërfshirës dhe, për të kursyer kohë, shpesh anashkalohet. Në mënyrë të ngjashme, për të kursyer kohën e nevojshme për të krijuar staf të ri të përhershëm me fjalëkalime për të hyrë në sistemet e kompanisë, është krijuar një përdorues i përgjithshëm 'administrator', me fjalëkalimin 'fjalëkalim'. Shumë personel të përkohshëm i qasen sistemit në këtë mënyrë.

RDO ka një aplikacion softuerik inteligjent i cili vazhdimisht kërkon në internetin për ndryshimet e çmimeve të produktit, duke i ngarkuar ato në rishikimet e dyqanit në internet në fjalë. Ndonjëherë, megjithatë, ka pasur probleme. Zakonisht kjo ndodh kur aplikacioni nuk e ka njohur një faqe të vjetër dhe ka zëvendësuar çmimin e saktë të fundit me një çmim të vjetër që gjendet në faqen e vjetër. Për më tepër, ky aplikacion softuerik inteligjent ka nevojë për qasje të përhershme dhe të vazhdueshme në internet, dhe RDO ka identifikuar një problem me firewall (program ose paisje për mbrojtje nga sulmet kibernetike) i cili ka penguar ndonjëherë aplikacionin softuerik që të përditësojë sistemet e brendshme. Për këtë arsye, është hequr mbrojtjen nga firewall për të siguruar që çmimet korrekte të azhurnuara të të gjitha dyqaneve online të shfaqen në faqen e internetit.

RDO rrallë gjeneron elemente të tjera të rishikimeve (siç është përvoja e produktit), duke e lënë këtë tek përdoruesit e regjistruar të faqes. Sidoqoftë, ajo herë pas here do të paraqesë rishikimin e vet për të ndihmuar në nxitjen e një dyqani që paguan një normë më të lartë të komisioneve sesa konkurrentët e saj. RDO është gjithmonë i sinqertë në rishikimet e tij, por sa më shumë komente që ka një dyqan, aq më lartë është në listën e kërkimit, kur një klient kërkon një produkt të caktuar.

Përdoruesit e regjistruar mund të dorëzojnë komente aq sa ata të dëshirojnë. Përdoruesit e paregjistruar mund të dorëzojnë gjithashtu komente, të cilat do të publikohen nën emrin 'anonim', por këta rishikues nuk do të jenë në gjendje të komentojnë në rishikimet e të tjerëve. RDO kontrollon rishikimet për përmbajtjen e duhur, por nuk kontakton me dyqane për të verifikuar saktësinë e rishikimit.

RDO është gati për të ndërmarrë një auditim të përshtatshëm të kontrollit të saj të përgjithshëm dhe aplikimit të IT-së. Përveç kësaj, RDO aktualisht është duke bërë një kontroll të brendshëm të qeverisjes etike, i cili ka identifikuar dy fusha kryesore shqetësuese:

(1) Konfliktet tregtare të interesit

Siç u përmend më herët, objektivi i biznesit të RDO-së është të "sigurojë një rishikim të paanshëm të dyqaneve online për të siguruar që konsumatorët kanë të gjitha informacionet në dispozicion". Megjithatë, auditimi ka zbuluar se të dy burimet e të ardhurave të RDO -së mund të shkaktojnë një dilemë etike në lidhje me këtë objektiv.

(2) Zyrat e kompanisë

RDO ka pak nevojë për zyra tradicionale, pasi nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorët. Kjo kërkon kryesisht teknikë të teknologjisë informative (IT) për të mbështetur shërbimet e saj të automatizuara. Kompania ka kryer hulumtime që sugjerojnë se aftësitë e IT-së që kërkohen mund të sigurohen me një normë shumë më të ulët jashtë shtetit. Kompania po konsideron zhvendosjen në një vend të tillë. Ky vend ka norma të ulëta të tatimit në korporata dhe kosto më të lira të punës. Megjithatë, vetë vendi është i rregulluar dobët dhe nuk ka legjislacion në lidhje me cilësinë e sistemeve të informacionit ose sigurinë e të dhënave të përmbajtura brenda tyre, veçanërisht në lidhje me të dhënat personale. Kultura e vendit është e tillë që pranimi i pagesave të paautorizuara për shërbimet nuk është gjithashtu e pazakontë. Përderisa RDO nuk e lejon këtë në kodin e saj të sjelljes, është e vetëdijshme se ekzistojnë çështje të tilla në vendin që po shqyrtohet.

Kërkohet:

- (a) Vlerësoni përshtatshmërinë e kontrolleve të përgjithshme dhe të aplikimit brenda RDO-së, në lidhje me teknologjinë e saj të informacionit dhe sistemet e informacionit. Sugjeroni ndonjë përmirësim që konsideroni të jetë e nevojshme.

(15 pikë)

- (b) Vlerësoni qeverisjen e korporatave dhe dilemat etike të identifikuara nga RDO në zhvendosjen e saj të mundshme në vendin e huaj dhe diskutoni implikimet e këtyre mbi misionin organizativ, qëllimin dhe strategjinë.

(10 pikë)

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhja

(a) RDO ka njohur rëndësinë e nevojës për sisteme funksionale gjatë gjithë kohës dhe kështu ka siguruar që një rezervë është në dispozicion. Ky është çelësi, pasi çdo humbje e funksionalitetit do të ndikojë në aftësinë e saj për të vepruar, duke marrë parasysh që të gjitha operacionet kryhen online. Megjithatë, ka disa probleme me kontrollet e saj të përgjithshme, të cilat mund të pengojnë rëndë biznesin.

Kontrollet e përgjithshme

Këto janë kontrolle që lidhen me mjedisin kompjuterik dhe, për rrjedhojë, mund të ndikojnë në ndonjë ose të gjitha aplikacionet në përdorim. Këto mund të jenë politika në lidhje me trajtimin e harduerit ose prokurimit për shembull, ose mund të jenë procedura specifike të sigurisë të cilat janë në vend. RDO duket se e njeh nevojën për kontrolle të përgjithshme duke pasur një qendër të veçantë kompjuterike, me qasje të sigurtë, një sistem firewall dhe një sistem fjalëkalimi për të mbrojtur nga aksesit i paautorizuar. Sidoqoftë, pavarësisht nga kjo njohje, ekzistojnë një sërë fushash ku kontrollet e përgjithshme nuk janë të përshtatshme.

Qendra kompjuterike nuk është e siguruar pavarësisht aftësisë për ta bërë këtë. Arsyeja e dhënë nuk është e mjaftueshme për të rrezikuar kontrollet e sigurisë për të. Megjithëse "pjesa më e madhe e stafit" në zyrat qendrore janë personel mbështetës IT, ka ende një staf që nuk duhet të ketë qasje në qendrën kompjuterike. Në të vërtetë, jo të gjithë stafi i IT duhet të ketë qasje në serverët kryesorë. Stafi i përkohshëm nuk duhet të përmbushë rolet që janë strategjike të rëndësishme dhe kështu, për të rrezikuar të gjithë operacionet duke u siguruar atyre akses të pakufizuar, RDO nuk po tregon kontroll adekuat. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i një përdoruesi të përgjithshëm dhe fjalëkalimi i thjeshtë do të thotë se ata kanë qasje jo vetëm në harduer, por edhe në të gjithë sistemin. Identifikuesi i përdoruesit dhe fjalëkalimi do të ishin të thjeshta për të menduar nëse dikush duhet të përpiqet të hyjë në sistem. RDO duhet menjëherë të kthehet në sistemin e aksesit të gjurmëve të gishtave dhe duhet të sigurojë që i gjithë stafi është i vetëdijshëm për rëndësinë e parandalimit të qasjes së paautorizuar. Përdoruesi i "administratorit" duhet të hiqet menjëherë, dhe vetëm ata me të drejta administratori duhet t'u ofrohet kjo në lidhje me ID e tyre unike të përdoruesit. Stafi i përkohshëm duhet të lëshohet me ID unik të përdoruesit në mënyrë që RDO të konstatojë se kush ka kryer ndonjë transaksion në sistem. Për më tepër, përdoruesit duhet të kujtohen për domosdoshmërinë e ndryshimit të fjalëkalimeve rregullisht dhe mos t'i shkruajnë ato kudo. Kjo mund të zbatohet në trajnim dhe në sigurimin e një dokumenti të procedurave.

Firewall është fikur për të lejuar që softueri inteligjent të ngarkoj gjetjen e tij në sistemin e RDO-së. Për fat të keq, fikja e firewall jo vetëm që lejon që kjo të ndodhë, por gjithashtu i hap sistemet për kërcënimin e hakerëve. Firewall duhet ri-instaluar menjëherë. Nëse po has vështirësi me aplikimin, mund të jetë se ekziston një rrezik sigurie me këtë. Kjo duhet të hetohet dhe korrigjohet tërësisht.

SRO ka ndërmarrë masa paraprake për të pasur një sistem rezervë si emergjencë kundër fatkeqësive. Megjithatë, sistemi duhet të jetë në një vend të largët, në vend se të jetë në të njëjtin vend si serverët kryesor. Për shembull, nëse do të kishte një zjarr, do të preknin serverët kryesorë dhe serverët rezervë. Në mënyrë të ngjashme, duke pasur një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të serverëve, çdo korrupsion i të dhënave ose akses i paautorizuar do të prekte si serverat ashtu edhe backup-at e tyre. Duhet të ketë një vonesë të lehtë në lidhje për të parandaluar këtë ngjarje, kështu që menjëherë sapo të zbulohet një problem, lidhja mund të ndërpritet, duke lejuar që rezerva të mos jetë e ndikuar.

Kontrollet e përmendura më lart do të preknin të gjitha sistemet. Ekzistojnë disa kontrolle që prekin vetëm aplikacionet specifike të përdorura nga organizata. Këto njihen si kontrolle të aplikimit dhe ndihmojnë që transaksionet të autorizohen dhe të regjistrohen, përpunohen dhe raportohen plotësisht dhe me saktësi.

Kontrollet e aplikacioneve

Ka disa çështje me kontrollet e aplikimit në sistemin e rishikimit, të cilat përbëjnë kërcënim për saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të dhënë në sistem.

Softueri inteligjent duket se ofron informata të vjetruara dhe aktualisht nuk ka asnjë mënyrë për të vlerësuar nëse ky është rasti. Një kontroll i verifikimit mund të jetë i nevojshëm për të konstatuar datën e dërgimit fillestar të informacionit dhe nëse kjo është më e hershme ose më e vonshme se data e informacionit që tashmë është mbajtur.

Shqyrtimet e bëra nga përdoruesit mund ose jo, të jenë një përfaqësim i drejtë i shërbimit të ofruar. RDO nuk verifikon se informacioni është i saktë, as nuk verifikon nëse përdoruesit janë ata që pretendojnë të jenë. Në të vërtetë, aftësia për përdoruesit për të postuar në mënyrë anonime do të thotë se ata mund të postojnë çfarëdo që ata dëshirojnë. Ekziston mundësia që përdoruesit të mund të punësohen nga dyqanet që po rishikohen, dhe të japin komente pozitive në mënyrë që të përfitojnë prej tyre. Përndryshe, ata mund të postojnë komente negative për konkurrentët e tyre, duke dëmtuar përsëri besueshmërinë dhe pavarësinë e rishikimeve. Nëse kjo do të ndodhte dhe do të zbulohet, kjo mund të kërcënonte ekzistencën e tërë RDO-së. Mund të ndodhë që duhet të përfshihet një kontroll, ku rishikuesit mund të paraqesin vetëm një rishikim nëse ka pasur një transaksion të vërtetë me dyqanin. Në mënyrë të ngjashme, dyqanet duhet të kenë mundësinë të reagojnë ndaj një rishikimi, të thjeshtëzuar nëse ka një identifikues transaksioni të disponueshëm.

Në përgjithësi, duket se, pavarësisht se ka shumë mjete në dispozicion, RDO nuk i përdor ato në mënyrë adekuate. Procedurat duhet të përcaktohen qartë dhe të respektohen për t'u mbrojtur nga rreziqet e tilla.

(b) Ka dy fusha shqetësuese të identifikuar nga RDO:

Konfliktet tregtare të interesit

Objektivi i biznesit i RDO është të 'sigurojë një rishikim të paanshëm të dyqaneve online për të siguruar që klienti ka të gjitha informacionet në dispozicion'. Pra, për të përmbushur këtë objektivi ata duhet të përqendrohen në të dy termat 'të paanshëm' dhe 'të gjithë informacionin në dispozicion'. Fakti që RDO ofron disa rishikime vetë, të cilat, megjithëse të ndershme, kërkojnë të tregojnë dyqane të caktuara në një dritë pozitive, shkelin këtë objektivi.

Dilema për RDO është se vetë dyqanet online ofrojnë të dy grupe të rrjedhave të të ardhurave për RDO. Është në interesin e RDO-së që rishikimet janë të sakta, përndryshe ata do të humbasin përdoruesit e saj që mbështeten në RDO për një rishikim të sinqertë dhe të vërtetë. Duhet të përdorin një faqe tjetër krahasimi, ose dyqan rreth vetes, RDO nuk do të fitojë të ardhura nga komisioni ose reklama. Megjithatë, nëse komentet janë negative, gjithashtu nuk ka gjasa që dyqani në fjalë të reklamojë në të ardhmen në faqen e RDO-së dhe komisionet e shitjeve do të bien, pasi përdoruesit e faqes së RDO-së nuk do të ndjekin lidhjet drejt një dyqani me komente negative.

RDO ose ka nevojë të ndryshojë objektivin e saj të biznesit për të hequr termat 'të paanshëm' dhe 'të gjithë informacionin në dispozicion', ose duhet të marrin në konsideratë se si ta bëjnë këtë duke ruajtur rrjedhat e tyre të të ardhurave. Idealisht, sigurimi i rishikimeve të ndershme duhet të inkurajojë dyqanet për të ofruar një shërbim të mirë në çdo kohë dhe pastaj kjo nuk do të ishte më një problem.

Zhvendosja e operacioneve të kompanisë

RDO po shqyrton lëvizjen e operacioneve të saj në një vend jashtë shtetit me përfitime tatimore dhe kosto. Përderisa kjo mund të duket të jetë një opsion tërheqës nga një perspektivë financiare, ka elemente të tjera që duhet të merren parasysh.

Dilema është se përfitimet e fituara financiarisht mund të kundërshtohen nga problemet operacionale. Vendi që ata po e konsiderojnë të zhvendosen është i rregulluar dobët dhe nuk ka kontrole legjislative në lidhje me cilësinë e sistemeve të informacionit apo sigurinë e të dhënave të përmbajtura brenda tyre, madje edhe për të dhënat personale. Kjo mund të çojë në rrezikun e humbjes së të dhënave personale të përdoruesve të regjistruar, gjë që mund të shkaktojë dëme të mëdha reputacioni, nëse ndodh. RDO ka njohur tashmë disa problem të kontrollit me sistemet e saj dhe ka të ngjarë që këto të përkeqësohen në një vend të rregulluar keq.

Është përmendur se kultura e vendit është e tillë që pranimi i pagesave të paautorizuara konsiderohet i pranueshëm, edhe nëse nuk është pranuar publikisht. RDO do të kishte dilemën se a do të sillte brenda kulturës së vendit, megjithëse sjellja e tillë e biznesit mund të konsiderohet e paligjshme ose e konsideruar jo etike në vendin e saj të origjinës ose nëse do të marrë një qëndrim kundër tij dhe kështu të vendoset në një disavantazh konkurrues. Ky i fundit do të ishte në përputhje me kodin e tyre të tanishëm të sjelljes, por mund të jetë e vështirë të bindësh personelin e burimeve lokale.

Duke qenë se Amy krijoi kompaninë kohët e fundit, në vitin 2010, me qëllim të tejkalimit të sjelljeve joetike që ajo perceptoi që ekzistonin në industrinë online të shitjes me pakicë, do të dukej se të dyja dilemat e shqyrtuara më sipër do të rrezikonin të gjithë paradigmën e kompanisë, arsyeja e saj për ekzistencë.

Problemi 3

Kompania Festa (KF) aktualisht ofron shërbime të agjencioneve të udhëtimit duke u dhënë këshilla udhëtimi dhe duke bërë rezervime udhëtimi për klientët që vizitojnë fizikisht zyrat e vendosura në shumicën e qyteteve kryesore të vendit. Sidoqoftë, ajo po zvogëlon gradualisht këtë pjesë të biznesit ndërsa në të njëjtën kohë përpiqet të arrijë një pjesë më të madhe të të ardhurave online.

Për të ndihmuar në përmbushjen e këtij objekti, KF është në procesin e formimit të një njësie të re biznesi për të tregtuar dhe shitur pushime luksoze për klientët. Gama e pushimeve të ofruara nga kjo njësi e re biznesi do të quhet "Inspirimi". Është menduar që "Inspirimi" do të ofrojë një shërbim pushimesh me cilësi të lartë, për klientët e dalluar. KF ka vendosur që kjo njësi e re biznesi të ketë edhe misionin e vet që është 'ofrimi i një shërbimi me cilësi të lartë për udhëtarët e dalluar'. Drejtori i ri i "Inspirimi" ka deklaruar se ka një objektiv për të arritur të ardhurat vjetore prej € 100 milion deri në vitin 2018. Kjo do të ishte përafërsisht 25% e të ardhurave totale të parashikuara për KF atë vit, por pritet të përfaqësojë vetëm rreth 5% të numri i përgjithshëm të pushimeve të shitura nga KF. Llojet e pushimeve të ofruara nga "Inspirimi" janë ofruar tashmë nga disa prej konkurrentëve të KF.

Dino Klosi, drejtori i ri i marketingut të "Inspirimi", ka deklaruar se interneti duhet të përdoret gjithnjë e më shumë si burimi kryesor i marketingut dhe shitjes së pushimeve, pasi që pothuajse kanë kaluar ditët kur familjet vizitojnë një agjenci udhëtimi të largët të planifikojnë pushimet e tyre; kjo bëhet nga komoditeti i shtëpisë '. Ai beson se klientët potencialë të "Inspirimi" nuk do të duan të vizitojnë agjencitë e udhëtimit të largëta. KF aktualisht përdor në masë të gjerë teknikat tradicionale të marketingut, duke dërguar broshura udhëtimi që përmbajnë të gjitha llojet e pushimeve që ofron për klientët potencialë. Sidoqoftë, siç e ka pranuar edhe Dino, "problemi është se ne as që e dimë nëse klientët tanë shqetësohen të hapin këto broshura, apo i vendosin ato direkt në kosh." Këto broshura shpesh prodhohen muaj më parë dhe mund të përmbajnë edhe pushime që nuk janë më në dispozicion. Konsumatorët nuk do ta zbulojnë këtë derisa të vizitojnë një nga agjentët e udhëtimit. Kompania aktualisht bën njëfarë përdorimi të email-eve në shënjestër, por është akuzuar për dërgimin e një mesazhi spam në të kaluarën dhe numër të madh të email-eve për të gjitha ofertat aktuale të pushimeve për të gjithë të regjistruar në bazën e saj të të dhënave.

Dino është i prirur të përvetësojë mundësitë e ofruara nga marketingu elektronik dhe beson se "Inspirimi" mund të përfitojnë shumë duke shfrytëzuar parimet e inteligjencës, individualizimit, ndërveprimit, integritit dhe pavarësisë së lokacionit të cilat janë qendrore për marketing elektronik.

